

# E DREJTA NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

## PLAN-PROGRAM ("SYLLABUS")

### SEMESTRI VEROR - VITI 2025

*Profesori:* Dr. Qerim QERIMI

*Orët e ligjëratave:* E hënë: 09:00 – 11:15 (AM) dhe e hënë: 11:30-13:45 (AM)

*Orët e konsultimeve:* E hënë: 11:15 – 11:30; 14:15–15:30, si dhe me paracaktim

E-mail: [qerim.qerimi@uni-pr.edu](mailto:qerim.qerimi@uni-pr.edu)

#### *Teksti i kërkuar:*

- GENTIAN ZYBERI DHE QERIM QERIMI, E DREJTA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT (2015).

#### *Materiale plotësuese:*

- PËRMBLEDHJE E MARRËVESHJEVE DHE INSTRUMENTEVE LIGJORE NDËRKOMBËTARE (QERIM QERIMI, REMZIJE ISTREFI & FLAKRON SYLEJMANI, 2016).
- TË DREJTAT E NJERIUT SIPAS JURISPRUDENCËS SË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (ILIRIANA ISLAMI, REMZIJE ISTREFI & QERIM QERIMI, 2018).

#### *Tekstet e rekomanduara:*

- ZEJNULLAH GRUDA, MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT (2010).
- RAIJA HANSKI DHE MARKKU SUKSI, HYRJE NË MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (INSTITUTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, UNIVERSITETI I ABO AKADEMISË, 1999).
- PËR NJË REND PUBLIK EUROPIAN (VENDIME TË ZGJEDHURA TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT, VËLLIMI I; TIRANË, 2001).
- RASTET KRYESORE TË KOMITETIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PËRMBLEDHUR NGA RAIJA HANSKI DHE MARTIN SCHEININ, 2003).

#### *Tekstet e rekomanduara (në gjuhën angleze):*

- LOUIS HENKIN ET AL., HUMAN RIGHTS (FOUNDATION PRESS, 2009).
- HENRY J. STEINER & PHILIP ALSTON, INTERNATIONAL HUMAN RIGHTS IN CONTEXT: LAW, POLITICS, MORALS (OXFORD UNIVERSITY PRESS, 2000).

## **PËRSHKRIMI I LËNDËS DHE QËLLIMET:**

Kjo lëndë ka për qëllim parësor që të ofrojë një studim të rendit publik ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Si struktura institucionale, ashtu dhe korniza ligjore në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe mekanizmat për zbatimin e kësaj kornize – duke përfshirë këtu dhe një analizë kritike të përshtatshmërisë së strukturës aktuale institucionale dhe zbatuese – paraqesin thelbin e përmbajtjes dhe të interesimit të kësaj lënde.

Përveç studimit të kornizës ligjore dhe institucionale të Kombeve të Bashkuara dhe të sistemeve rajonale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, kjo lëndë po ashtu ka për qëllim shqyrtimin dhe kuptimin e diskursit dhe lëvizjes për të drejtat e njeriut, veçanërisht nga periudha pas Luftës së Dytë Botërore.

Qëllimet e tjera të lëndës kanë të bëjnë me analizën dhe shqyrtimin e dispozitave, rasteve, standardeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe masave në dispozicion kundër këtyre shkeljeve në sistemin ekzistues ndërkombëtar dhe në sistemet rajonale të të drejtave të njeriut, me theks të veçantë në sistemin evropian të të drejtave të njeriut. Një përqendrim tjetër i veçantë i kësaj lënde është shqyrtimi i kornizës kushtetuese dhe institucionale për të drejtat e njeriut në zbatim në Kosovë, përfshirë zbatimin në praktikë të të drejtave të mbrojtura kushtetuese në rendin juridik të Kosovës. Kjo do të bëhet përmes analizës së një sërë rastesh të zgjedhura gjyqësore nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Përfundimisht, struktura e kësaj lënde është e organizuar në një mënyrë që në thelb përfshinë tri shtylla kryesore, dhe ka për qëllim: (1) Së pari, të ofrojë një hyrje konceptuale për të drejtat e njeriut; (2) së dyti, të paraqesë dimensionin institucional të sistemit ndërkombëtar (përfshirë atë rajonal dhe vendës) për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, dhe (3) së treti, të analizojë dhe studiojë çështje, raste dhe të drejta specifike të njeriut.

## **VLERËSIMI:**

Do të ketë një testim mes-semestral dhe një testim përfundimtar, që do të mbulojnë, përveç nëse u thuhet ndryshe, materialet e detyrueshme për lexim, si shtesë e asaj që është thënë në ligjërata dhe ushtrime. Vlerësimi do të jetë si në vijim:

- Testi mes-semestral: 40 për qind (%)
- Testi përfundimtar: 50 për qind (%)
- Pjesëmarrja aktive dhe e rregullt në ligjërata: 10 për qind (%)

Do të ketë një politikë rigoroze në përcaktimin e vijueshmërisë së lëndës dhe çfarëdo mungese, e jo më tepër se tri, do të trajtohet me kujdes të shtuar.

Si shtesë e metodës së vlerësimit të shpallur si më sipër, pjesëmarrja cilësore ose përmbajtjesore në diskutimet gjatë ligjëratave dhe/ose ushtrimeve mund të vlerësohet edhe me 10 për qind (%) të tjerë. Nëse pjesëmarrja, në cilësi dhe përmbajtje, është e mjaftueshme për të marrë këtë përqindje, vendimi përfundimtar për këtë përcaktim i takon profesorit të lëndës.

Rezultati përfundimtar, pra, do të përcaktohet nga rezultati i akumuluar në dy testet e organizuara gjatë semestrit (mes-semestral dhe përfundimtar) dhe cilësia e vijueshmërisë në ligjërata.

Një minimum prej 55 për qind (%) është i nevojshëm për notë pozitive kaluese.

## OBJEKTIVAT E LËNDËS:

Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të:

1. Kuptojnë dhe shpjegojnë origjinat intelektuale, kuptimin dhe zhvillimin e diskursit dhe të lëvizjes së të drejtave të njeriut;
2. Kuptojnë dhe shpjegojnë sistemin aktual botëror të të drejtave të njeriut, si burimet ashtu dhe institucionet dhe instrumentet kryesore ligjore në fuqi;
3. Kuptojnë dhe shpjegojnë sistemet rajonale për të drejtat e njeriut, veçanërisht sistemin evropian të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut;
4. Njohin dhe përdorin procedurat ekzistuese në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si në nivel të Kombeve të Bashkuara ashtu dhe në nivel rajonal;
5. Njohin dhe kuptojnë aspekte specifike të të drejtave të njeriut, si për shembull të drejtën në jetë dhe të drejtën në gjykim të drejtë, të drejtat e pakicave dhe të drejtën për vetëvendosje, ndalimin e diskriminimit apo të drejtat e njeriut në konflikte të armatosura, si dhe sfidat në realizimin e këtyre të drejtave; dhe
6. Përdorin dhe analizojnë në mënyre kritike raste dhe dokumente ligjore në kontekst të problemeve konkrete në botën reale.

## METODOLOGJIA

Metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret në zbatimin e programit të kësaj lënde mbështetet në analizën e thellë të materialeve të përzgjedhura sipas udhëzimit të profesorit të lëndës. Studentët duhet të ballafaqohen me problemet e jetës së përditshme të hulumtimit dhe interpretimit, të zgjedhura midis atyre më të shpeshta dhe tipike në proceset vendimmarrëse dhe të ligjbërjes ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, me përparësi ndaj atyre që kanë ose mund të kenë një korrelacion më të përfaqësues me përvojat dhe nevojat në Kosovë. Me fjalë të tjera, nuk do të prezantohen vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to.

Do të bëhet, gjithashtu, *përpyetje* për një ekuilibrim të përhapjes së njohurisë mbi tiparet kryesore të sistemit institucional ndërkombëtar dhe nocioneve më të specializuara, ndonëse orientimi parësor do të jetë – i motivuar nga filozofia udhëheqëse në këtë rast – se njohuria bazë mund të përftohet më lehtë si derivat i diskutimit të përqendruar në probleme të specializuara, përparësia e të cilës empirikisht qëndron në një shkallë më të lartë probabiliteti të ngritjes apo rritjes së aftësisë ose shkathtësisë dhe kapacitetit për të zotëruar nocione më specifike dhe për të vepruar në kontekste më praktike.

Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë, kërkohet që paraprakisht të lexohen materialet për temën e cila diskutohet në orën(-t) pasuese, për të krijuar një kuptim të përgjithshëm dhe njohje paraprake me materialin dhe tërësinë e ndryshueshmërinë e temave që do të diskutohen në ligjërata.

### Vërejtje:

Ju lutem vëreni se ky është një *projekt* plan-program dhe mund të ndryshohet, përmirësohet apo përshtatet gjatë zhvillimit të lëndës për qëllime të rezultatit më të mirë të studentëve.

## ORARI DHE PËRMBAJTJA E LIGJËRATAVE

### Java e Parë:

#### HYRJE & KUPTIMI DHE HISTORIKU I TË DREJTAVE TË NJERIUT

- *Përmbajtja, organizimi dhe kërkesat e lëndës; metodologjia e mësimdhënies; dhe metoda e vlerësimit*
- *Origjinat dhe kuptimi i të drejtave të njeriut*

*Zyberi & Qerimi,  
fq. 23-42.*

### Java e Dytë:

#### BURIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

*Zyberi & Qerimi,  
fq. 66-91.*

### Java e Tretë:

#### SISTEMI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E NJERIUT: INSTRUMENTET DHE INSTITUCIONET

*Zyberi & Qerimi,  
fq. 92-113.*

### Java e Katërt:

#### “KARTA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE”: DEKLARATA UNIVERALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE PAKTET PËR TË DREJTAT E NJERIUT

*Zyberi & Qerimi,  
fq. 48-57 dhe  
122-147.*

### Java e Pestë:

#### SISTEMET RAJONALE TË MBROJTJES DHE PROMOVIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT: SISTEMI EVROPIAN I TË DREJTAVE TË NJERIUT

*Zyberi & Qerimi,  
fq. 57-65 dhe  
113-120.*

**Java e Gjashtë:**

**TË DREJTAT E NJERIUT NË RENDIN JURIDIK TË KOSOVËS**

*Zyberi & Qerimi, fq. 168  
- 192.*

**Java e Shtatë:**

**TESTI MES-SEMESTRAL**

**Java e Tetë:**

**E DREJTA NË JETË DHE NDALIMI I TORTURËS OSE TRAJTIMIT APO NDËSHKIMIT MIZOR,  
ÇNJERËZOR OSE DEGRADUES**

*Zyberi & Qerimi, fq. 215  
- 223; dhe rastet për të  
drejtën në jetë në shtojcën  
II: fq. 366-373.*

**Java e Nëntë:**

**E DREJTA NË GJYKIM TË DREJTË DHE E DREJTA E PRIVATËSISË**

*Zyberi & Qerimi, fq. 223-  
226 dhe 230-233.*

**Java e Dhjetë:**

**E DREJTA PËR ARSIM DHE E DREJTA NË PRONË**

*Zyberi & Qerimi, fq. 237  
- 241; dhe rastet në  
shtojcën II për mbrojtjen  
e pronës: fq. 374-378.*

**Java e Njëmbëdhjetë:**

**NDALIMI I DISKRIMINIMIT (DHE E DREJTA PËR ZHDËMTIM NË RAST SHKELJESH TË RËNDA TË TË  
DREJTAVE TË NJERIUT)**

*Zyberi & Qerimi, fq. 241-  
249.*

**Java e Dymbëdhjetë:**

**MBROJTJA E PAKICAVE & E DREJTA E VETËVENDOSJES**

*Zyberi & Qerimi, fq. 40-41 dhe 45-47.*

**Java e Trembëdhjetë:**

**TË DREJTAT E NJERIUT NË NJË KOHË NDRYSHIMESH: SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT**

*Zyberi & Qerimi, fq. 252-262.*

**Java e Katërbëdhjetë:**

**TË DREJTAT E NJERIUT NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA**

*Zyberi & Qerimi, fq. 263-285.*

**Java e Pesëmbëdhjetë:**

**TESTI PËRFUNDIMTAR**